



ANALIZA

Barrierat e përfshirjes aktive të grave të kategorive të prekura në tregun e punës

Autore: Afërdita Haxhijaha Imeri

Shkup 2016



Shoqata e zejtarëve dhe afaristëve
The Craftsmen and Entrepreneurs
Association
Prizren

Ky aktivitet është mbështetur financiarisht nëpërmjet projektit Barazia ndërkufitare dhe integrimi gjinor, financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa i implementuar nga Akcija Zdruzhenska, Shkup dhe nga Instituti për zhvillimin e komunitetit, Tetovë. Për përmbajtjen e dokumentit përgjegjës është Forumi i gruas, dhe në asnjë rast nuk i reflekton pozicionet e Bashkimit Evropian dhe zbatuesit e projektit.

Hyrje

Shoqata e Forumit të Grave në Tetovë në partneritet me Dorën e artë Tetovë, iu rrek përgatitjes së analizës për barrierat limituese që i pengojnë gratë të kategorive të prekura për t'u përfshirë në tregun e punës në kuadër të projektit "Me përforsim ekonomik drejt barazisë gjinore". Ky aktivitet është pjesë e projektit "Barazia ndërkufitare dhe integrimi gjinor" i Shoqatës së përparimit të barazisë gjinore. Akcija Zdruzhenska - Shkup që implementohet në partneritet me Institutin e komunitetit në Tetovë. Projekti është mbështetur nga BA në kuadër të IPA instrumentit për bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës.

Qëllimi i projektit është që të nxisë përforsimin ekonomik të grave në nivelin lokal si faktor për përmirësimin e barazisë gjinore. Nëpërmjet qëllimeve specifike të projektit do të synohet që të përcaktohen faktorët kryesor që ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e ulët në tregun e punës të grave të kategorive të prekura; të lehtësohet qasja e grave të kategorive të prekura në tregun e punës; të vendoset bashkëpunimi me organizata të ngjajshme nga Kosova, të shkëmbehen përvoja, praktika dhe të propozohen zgjidhje.

Kjo analizë ka si qëllim të përcaktojë barrierat e limitimit që i pengojnë gratë e kategorive të prekura të përfshihen në tregun e punës. Barrierat e përcaktuara duhet të shërbejnë si bazë për vlerësim të mëtejshëm të motivimit të grave për t'u përfshirë në procesin e mëtejshëm për përforsimin e tyre ekonomik.

I. Metodologjia

Për përgatitjen e analizës është përdorur qasja ndaj grupeve të fokusit si formë më e shpeshtë e hulumtimeve kualitative. Me to trajtohet një temë e caktuar, problemi, dukuria shoqërore ose tregu.


Duhet përmendur se në hulumtimet kualitative, gjatë analizës së rezultateve, numrat nuk janë aq të rëndësishëm se sa detektimi i cilësisë. Theksi vihet tek pyetjet pse dhe si, përkundër hulumtimeve kuantitative në të cilat theksi kryesor vihet tek pyetjet ku, kur dhe sa.

Gjithsej u bë implementimi i 4 grupeve të fokusit dhe atë në Tetovë, Selcë, Shipkovicë dhe në Jergunovcë. Në Tetovë pjesëmarrësit në grupin e fokusit ishin gra gjatë kohë të papunë ndërsa në tri grupet e fokusit tjetër në Selcë, Shipkovicë dhe në Jergunovcë pjesëmarrëset ishin gra të papunësuar nga mjediset rurale. Nëpërmjet nxitjes për diskutim gratë e hulumtuara paraqitën qëndrimin, mendimin dhe reagimin e tyre, për aspektet kualitative të problemit/temës së diskutimit.

Çdo grup i fokusit kishte mesatarisht 7-11 gra hulumtimi ndërsa diskutimi me ta zgjaste rreth 2,5 orë. Diskutimet qenë koordinuar nga moderatorja, sipas një doracakut të përgatitur më parë nëpërmjet shfrytëzimit të tabelës për vizualizim të pyetjeve dhe përgjigjeve. Për çdo grup të fokusit u përgatitën shënime të detajuara për diskutim.


Profili i pjesëmarrëseve të grupeve të fokusit:

Gjithsej u përfshinë 33 pjesëmarrëse në të gjitha katër grupet e fokusit. Shpërndarja e pjesëmarrëseve në çdo grup të fokusit është paraqitur në vijim:




Sipas moshës të pjesëmarrëseve numri më i madh (17) janë me moshë ndërmjet 30 dhe 39 vjet, ndërsa grupmoshat 20-29 dhe 40-49 vjet u përfshinë në mënyrë të barabartë.

Detajet mund të shihen në vijim:



Kur bëhet fjalë për arsimimin, pjesëmarrëset e përfshira ishin me strukturë të ndryshme arsimore, duke nisur nga shkolla fillore deri te arsimimi sipërorë. Struktura është paraqitur në tabelën e mëposhtme:


Arsimimi i pjesëmarrëseve të GF



Nga gjithsej 33 pjesëmarrëse vetëm 7 ishin me përkatësi etnike Maqedonase ndërsa të tjerat me përkatësi etnike Shqiptare siç shihet edhe në tabelën në vazhdim:

Përkatësia etnike e pjesëmarrëseve të GF

■ Maqedonas ■ Shqiptarë



II. Faktorët që kontribuojnë për përparimin e pozitës së burrave dhe grave në komunitet/mjedis

Diskutimi i grupeve të fokusit tregoi se faktorët që ndihmojnë për përparimin e pozitës së burrave dhe grave në vendin ku jetojnë janë të natyrave të ndryshme. Për meshkujt faktorët për përparim janë të jashtëm dhe konkret si për shembull punësimi, arsimimi i mirë, hapja/ushtrimi i biznesit të suksesshëm, zejes ose angazhimi partiak.

Për gratë faktor për përparim në mjedis në radhë të parë është përkrahja e familjes (e burrit, e prindërve, e familjes së burrit) dhe të kuptuarit e nevojës që gruaja të kontribuojë në mënyrë të barabartë në buxhetin familjar nëpërmjet punës formale. Në këtë aspekt tejkalimi i normave shoqërore sipas së cilave nëse një grua punon burri do të përqeshet nga rrethi ku jeton si i paaftë, është ndër faktorët esencial për punësim dhe me këtë edhe avancimi i pozitës së grave në mjedisin ku jetojnë. Në lidhje me këtë çështje nuk ka dallime tek përgjigjet e mjediseve rurale dhe urbane. (Tetova krahasuar me tre grupet tjera të fokusit).

Me rëndësi është të theksohet se mospasja e kushteve për ruajtjen e fëmijëve (kopshteve ose qendrave për zhvillim të hershëm të fëmijëve) është identifikuar si barrierë vetëm në grupin e fokusit në Selcë dhe në Rogaçevë. Supozohet se shkak për këtë është për shkak të faktit se të hulumtuarat janë të papunësuar dhe se nuk kanë pasur as ofertë konkrete për punë ende nuk kishin menduar se kush do t'ua ruante fëmijët. Ose të hulumtuarat jetojnë në familje me të mëdha ku kujdesi për fëmijët bëhet edhe nga anëtarët e tjerë të familjes (nëna, vjerra ose fëmijë tjerë më të rritur).

Konkluzioni dhe rekomandimi: Natyra e ndryshme e faktorëve që ndikojnë në përparimin e burrave dhe grave në mjedisin e tyre nuk do të thotë se barrierat e evidentuara për gratë të tejkalohen, ato, pra gratë do të avancohen. Përkundrazi, pikërisht atëherë gratë do të ballafaqohen me barrierat me të cilat ballafaqohen edhe burrat. Ose thënë ndryshe me fjalë të tjera, gratë ballafaqohen me barrierat të dyfishta dhe si pasojë e kësaj gjasat për avancimin e tyre në mjedisin e vet janë dyfish më të vogla.

Nëse do të mendohej për mënyrat e përforcimit ekonomik të grave, aktivitetet duhet të orientohen jo vetëm në përmirësimin e punësimit të tyre në kuptimin e arsimimit, shkathtësive, gjuhëve dhe kompetencave por ndoshta jo edhe më esenciale, aktivitetet duhet të orientohen edhe tek burrat dhe tek anëtarët e tjerë të familjes me qëllim të tejkalimit të paragjyqimeve, stereotipave dhe të normave ekzistuese shoqërore për vlerat dhe nevojat për punësimin e gruas.

Vetëm me kombinimin e dy tipave të intervenimit mund të pritët arritje e rezultateve pozitive.

III. Çdo të thotë të jesh e punësuar?

Të jesh i punësuar nuk do të thotë vetëm të fitosh mjete financiare dhe kontribut në buxhetin familjar por do të thotë diç më shumë, sikurse tha një pjesëmarrëse e grupit të fokusit *“gruan e punësuar e definoj si të situinuar, të plotësuar dhe të pa limituar”*.

Edhe statusi i papunësisë lidhet me disa dimensione dhe nënkupton shumë gjera. Duke nisur nga *“varshmëria ekonomike”* deri te gjendja psikologjike e pakënaqësisë së përhershme për shkak të situatës personale, siç e përshkruan gratë në Shipkovicë, si dhe deri tek qëndrimet dhe dëshirat personale për punësim sipas rrëfimeve në fshatin Selcë *“nuk kërkon ose/dhe nuk kërkon të gjejë punë”*.

Edhe pse nga ajo që u tha më lartë mund të arrihet konkluzioni se ka shumë shkaqe për papunësinë dhe pasoja të saj në aspektin e faktit se ç'nënkuptojmë me punësim sezonal dhe vetëpunësim për këto dy nocione shumica e pjesëmarrëseve kanë qëndrime shumë të ngjashme. Puna sezonale

nënkupton ndonjë lidhje jo të përhershme me bujqësinë, zejtarinë dhe ndërtimtarinë. Në shumë raste puna sezonale nënkuptohet si më pak e preferuar dhe/ose si diçka që shpie drejt punësimit formal. Kjo më së miri është pasqyruar në grupin e fokusit në fshatin Rogaçevë me ç'rastë u tha se puna sezonale është *“sot ke nesër s'ke”* ose *“këta njerëz nuk janë të dekurajuar se megjithatë fitojnë diçka”*.

Jo më pak si i pa preferuar perceptohet edhe vetëpunësimi me ç'rast si formë e punësimit nënkuptohet puna në shtëpi, dhe si e këfillë edhe e pa preferuar për gratë të cilat punësimin e shohin edhe si gjasë për të dalë jashtë shtëpisë. Gjithashtu vetëpunësimi ka një konotacion të caktuar negativ sepse nënkupton burimin e mjeteve të pasigurta. *“Punë në shtëpi, fiton por nuk ka siguri për të ardhmen”*.

Të hulumtuarat, në të gjitha grupet e fokusit, konsiderojnë se çdonjëri është i papunësuar pa marr parasysh se punon në bujqësi te vet ose në tokën e tjetrit, në biznesin familjar, shet prodhime të veta dhe angazhohet kohë pas kohe në punë ndërtimore. Me fjalë të tjera nëse nuk merr pagë (rrrogë) nuk shkon në punë dhe nuk je i siguruar në shëndetësi dhe pension nuk llogariteni si i punësuar.

Konkluzioni dhe rekomandimet: Nga ajo që u tha më lart mund të nxirret konkluzion se ekziston kuptim shumë i limituar rreth asaj se kur një njeri është i punësuar ose i papunësuar. Në kuptimin e gjerë të fjalës punësimi lidhet vetëm për punën e zyrës dhe/ose puna në industri, ndërmarrje . dhe ente me çrast e punësuar duhet të ketë sigurim shëndetësor dhe pension.

Nga observimet e bëra më lartë duhet të rekomandohet se gjatë dizajnit të intervenimit që do të ketë për qëllim të ndikojë në përforcimin ekonomik të grave duhet të parashihen aktivitete të cilat do të kontribuojnë në vetëdijësim dhe në shpjegimin plotësues të formave të ndryshme të punësimit dhe angazhimit që të gjithë të pranohet si punësim sepse krijojnë të ardhura.

Edhe më qenësore është të parashihen aktivitete të cilat do të kontribuojnë në formalizmin e bizneseve të lidhura me bujqësinë ose bizneset familjare. Kjo para së gjithash ka të bëjë në rregullimin dhe definimin e të ardhurave në kuptimin e pagës dhe të kontributeve.

Marrja e kompensimit në të holla dhe pagimi i kontributeve të punës në biznese bujqësore dhe familjare është me rëndësi të posaçme për gratë sepse pikërisht në bujqësi dhe biznes familjar gratë rurale janë më tepër të angazhuara por puna e tyre nuk paguhet me pagë dhe me kontribute.

Zakonisht bizneset familjare ose ekonomitë bujqësore janë të regjistruara në emër të burrave dhe me mosmarrje të pagës gratë bien në pozitë të nënshtrimit. Kjo gjendje ka pasoja edhe në të ardhmen sepse me mospagimin e kontributeve të pensionit varshmëria ekonomike e grave vazhdon edhe në pleqëri dhe kur të jenë të paafta.

IV. Mënyra për të kërkuar punë

Në situatën kur as burri as gruaja nuk janë të punësuar burrat kërkojnë punë jashtë shtëpisë ndërsa gratë janë ato që përqendrohen në punë në shtëpi ose rreth punëve të shtëpisë.

Ekzistenca për të mbijetuar bëhet nëpërmjet ndihmës sociale ose nga prindërit që punojnë jashtë shtetit. Në një situatë të këtillë presioni shoqëror është shumë më i madh ndaj burrit sepse nga ai pritet të sjellë të ardhura në shtëpi. Gruaja nuk përjeton presion nga mjedisi sepse nga ajo nuk pritet që të fitojë jashtë shtëpisë. *“Për burrin është më vështirë, nga ai pritet gjithçka, nga ai kërkohet”*.

Në lidhje me faktin se nga merren informacionet rreth vendeve të punës, domethënë si ofrohet punë, gratë e qytetit (grupi i fokusit nga Tetova) i theksojnë burimet formale si për shembull agjencia për punësim, organizatat joqeveritare, interneti dhe gazetatat por me këtë rast nuk kanë besim të lartë tek këto burime *“por kur shpallja del kandidati më është zgjedhur, ato vende pune shpallen vetëm formalisht”*.

Ndryshe nga këto, gratë në mjediset rurale mbështeten më shumë në kontakte personale, nëpërmjet atyre që i njohin ose nëpërmjet grave me të informuara të cilat shkojnë në qytet ose informatat i gjejnë në internet, por vetëm kur dikush do t’ua tregojë ato.

Konkluzioni dhe rekomandimi: Gratë rurale nuk shfrytëzojnë metoda konvencionale për të zgjedhur punë sepse ose nuk besojnë në të njëjtat ose ato janë të pakapshme për to. Mundësitë për t’u punësuar gratë rurale më së shumti kuptohen nëpërmjet kontakteve personale ose kur informacionet do të shpërndahen nëpërmjet mjete të informacionit të kapshme për gratë rurale. Prandaj vendosja e informacioneve në viset ku qarkullojnë gratë dhe/ose nëpërmjet medimeve që shfrytëzohen edhe nga gratë (televizionet lokale ose nacionale në terminat e emisioneve me shikueshmëri të lartë nga ana e grave) është metoda më e rekomandueshme për shpjegimin e informacioneve për punësim ose për përfundim ekonomik të grave rurale.

Kur analizohen barrierat për gjetjen e punës për burra dhe gra, siç u përmend edhe më lartë për gratë barrierat janë të dyfishta, sepse përkrahja nga ana e familjes si dhe nevoja për tu ballafaquar me obligimet shtëpiake janë barriera plotësuese përkundër atyre me të cilat ballafaqohen edhe meshkujt.

Faktor qenësor i cili ndikon se një grua a do të gjejë punë është pamja e saj fizike. Kjo është veçanërisht qenësore për vendet e punës të cilat kanë kontakt me klientë si për shembull veprimtaritë shërbyese dhe administrata për shkak të stereotipave të përhershme se pamja ndikon në relacionin me klientin si dhe për shkak të stereotipave ekzistues se si duhet të duket një grua.

Rezultatet e grupeve të fokusit tregojnë edhe barriera tjera shtesë dhe kjo është se jo çdo punë pranohet nga gratë. Për shembull normat shoqërore imponojnë që gratë të pranojnë punë në dhënie të shërbimeve në profesione ku dominojnë gratë. Por edhe në raste të këtilla vetëm një tip i caktuar punësh është i pranueshëm por tjetri jo.

Për shembull për të qenë kamarriere është punë shoqërisht e papranueshme por të punohet në pozicione të prapavijës në kuzhinën e restorantit ose të hotelit është e pranueshme. Kjo ndodh për shkak të nënkuptuarit të disa vendeve të punës me vlerat morale dhe mundësia për etiketime nga mjedisi dhe komuniteti si “jo morale” ose “me moral të lehtë” nëse punohet në vende të këtilla. Në këtë drejtim për një grua nuk është e pranueshme të punojë në bastore sportive, byro shorti ose

në çajtoje si vende ku lëvizin vetëm burra. Mundësia për të gjetur punë të përhershme është gjithashtu është faktor që ndikon për suksesin në kërkimin dhe gjetjen e punës.

Edhe për gratë edhe për burrat përkatësi ndaj partisë politike veçohet si më qenësore, dhe mbase edhe faktori më qenësor për gjetje ose mos gjetje të punës. Nëse ndonjë që kërkon punë është anëtar i partisë politike e cila është në opozitë atëherë puna vështire gjendet. Faktorët tjerë sikurse është arsimimi dhe njohja e gjuhëve janë faktorë të radhitur si të rangut të dytë.

V. Si të hapim biznesin personal të vogël dhe menaxhimi i tij?

Kur bëhet fjalë për hapjen dhe menaxhimin e biznesit personal të vogël (dyqan) burrat dhe gratë ballafaqohen me barriera të ndryshme .

	Gra	Burra
Sa është vështirë	Shumë vështirë	Për të është shumë lehtë
Ç'është lehtësim	<p>Kur të kesh objektin tënd.</p> <p>Kur nuk do të kesh konkurrencë</p> <p>Kur do të ishte fshati më i madh (kërkesa më e madhe)</p> <p>Kur do të kishte më pak detyrime/tatime.</p> <p>Kur do të kishe ndonjë që do të kujdeset për obligimet shtëpiake dhe i ruan fëmijët</p> <p>Kur do të kisha kapitalin fillestar ose aftësi për kredi</p>	<p>Të kesh kapitalin tënd</p> <p>Ka shokë dhe kontakte</p> <p>Nuk ka limite në kuptimin e punës shtëpiake ose kujdes për fëmijët</p> <p>Nuk ballafaqohet me paragjykime</p> <p>Ai ka automjete dhe në këtë mënyrë është më i lëvizshëm për punë dhe kontakte në qytet</p> <p>Mund të hapë bastore, byro shorti ose çajtoje – ka më shumë zgjedhje</p>
Ndekja e trajnimit/kursit për të bërë biznes	Familja ose shokët e bëjnë pishman ose e dekurajojnë tepër (përveç në Selcë ku e inkurajojnë fortë)	E inkurajojnë dhe përkrahin fuqishëm
A do të vendosni bashkërisht	Po	<p>Vendosin bashkërisht dhe gruaja më shpesh i ruan paratë.</p> <p>Burri disponon parat dhe vendos</p>

Konkluzioni dhe rekomandimi: Kur bëhet fjalë për hapjen e biznesit të vogël barrierat me të cilat ballafaqohen gratë janë më të mëdha se sa ato me të cilat ballafaqohen burrat pa marrë parasysh se për nga arsimit ato janë të njëjtë.

Për gratë përveç obligimeve në shtëpi të cilat edhe më tutje nuk ka kush t'i marrë, mospasja e pronës në emër të vet dhe me këtë edhe pamundësinë për kreditim, paraqet faktorin serioz të limitimit.

Gjasat për suksesin e grave rurale në ushtrimin e biznesit të vogël zvogëlohen edhe më shumë për shkak të zvogëlimit të lëvizjes së tyre. Gratë nuk kanë automobila dhe me këtë limitohet mundësia e tyre për sigurimin e funksioneve themelore të biznesit siç është për shembull kontakti me furnizuesit dhe blerja e mallit.

Familja dhe rrethi në masë të madhe e dekurajojnë gruan të ndjekë trajnime dhe mundësitë e tjera zhvillimore për ushtrimin e biznesit për shkak të mosbesimit në institucione të cilat i zbatojnë ato trajnime por edhe për shkak të mosbesimit ndaj gruas se mund të përballlet me menaxhimin administrativ të biznesit *“do të mbesë në baltë financiarisht dhe do të futet në borxhe”*.

Jo më pak i rëndësishëm është edhe fakti se vendimet në lidhje me biznesin, kursimet dhe investimet e ardhshme pritet që ti marrë bashkë me burrin. Ndryshe nga kjo në rastin e kundërt kur burri është më i fortë në biznes ai ia jep t'ia ruaj grua por nuk e përfshinë atë në marrjen e vendimeve për investimet e ardhshme ose në zhvillimin e biznesit.

Rekomandohet që gjatë zhvillimit të intervenimeve të orientuara në përforsimin ekonomik të grave të përfshihen aktivitete të cilat do t'i ndihmojnë gruas të çlirohet nga koha kushtuar punëve shtëpiake sikurse është kujdesi për fëmijët nëpërmjet hapjes së kopshteve dhe qendrave për fëmijë. Marrja e një pjese të punëve të shtëpisë nga burri, anëtarët e tjerë të familjes ose pagesa e njerëzve të tretë për kryerjen e obligimeve shtëpiake nëpërmjet aktiviteteve drejtuar në vetëdijesimin edukimin e burrave ose gratë më të moshuara (nënat, vjehrrat) dhe me këtë edhe pranimi i mënyrës krejt ndryshe i kryerjes së detyrave punuese.

Gjithashtu aktivitetet e orientuara në rritjen e lëvizshmërisë së grave nëpërmjet përmirësimit të transportit publik ose të masave për marrjen e patentës së shoferit do të kontribuonte në ushtrimin e suksesshëm dhe të pavarur të biznesit.

Jo me pak rëndësi është edhe përmirësimi i aftësisë së kreditimit të grave, d.m.th. regjistrimi i pasurisë në emër të tyre. Nxitja e institucioneve për t'iu dhënë mbështetje bizneseve që menaxhohen në emër të grave ose aktivitetet e orientuara në drejtim të regjistrimit të pasurisë në emër të gruas (sipas shembullit të subvencioneve për gra pronare të tokës bujqësore) do të kontribuonte në përmirësimin e mundësive të grave në biznes.

Vënia në dukje dhe promovimi i shembujve pozitiv të grave të tjera (të mjedisve të ngjashme ose të njëjta) do të kontribuonte në ndryshimin e qëndrimeve të rrethit dhe do të nxiste ndryshime të aspekteve negative dhe të vështirësive shoqërore drejt atyre pozitive dhe mbështetëse.

VI. Kërkimi i punës në çdo mjedis dhe jashtë mjedisit tënd (në qytet ose shtet tjetër)

Gjatë shqyrtimit të mundësive dhe gjasave për punësimin e grave dhe të burrave në mjedisin e tyre, përveç në Tetovë (si mjedis urban qytetar) në mjediset e tjera fshatare nuk ka aspak dyshim se burrat kanë shanse shumë më të mëdha të gjejnë punë.

Këto gjasa kanë të bëjnë në radhë të parë për shkak të kërkesës më të madhe (dhe me këtë edhe zgjedhje) më shumë “mashkulli” për shembull në ndërtimtari ose tip tjetër të punës fizike si dhe të kontakteve dhe shoqërimeve më të mira.

Gratë pikërisht për këto shkaqe (limitimi i ofertës të punëve “të grave” dhe njohjeve më të pakta) kanë gjasa më të vogla për të gjetur punë.

Gjendje e njëjtë është edhe lidhje me mundësitë për të gjetur punë jashtë vendit të jetesës ose në ndonjë shtet tjetër. Më një përjashtim, në rastet kur bëhet fjalë për vajza të reja në Shipkovicë, në të gjitha grupet e fokusit dominon mendime se të kërkosh punë në qytet/shtet tjetër është vështirë edhe për burra edhe për gra.

Për punë jashtë shtetit duhet ditur gjuhën, të kesh mjete sa për fillim, të kesh ndonjë kontakt dhe/ose njohje që do të ndihmonte në fillim, visë pune dhe një përvojë të caktuar punuese. Duke marrë parasysh faktin se të gjitha këto gjëra pak a shumë janë më të kapshme për meshkujt se sa për gratë gjasat për tu punësuar të meshkujve jashtë vendit të jetesës ose në shtet tjetër janë më të mëdha.

Nëse ndonjë çift do të kthehet nga shteti tjetër, pasi të kenë punuar jashtë, dhe do të kërkonin punë mendohet se pa marrë parasysh a bëhet fjalë për burrë ose grua për shkak të përvojës dhe kapitalit të fituar ata mund të gjejnë punë më lehtë. Në masë më të madhe supozohet se do t'i rrekeshin hapjes së biznesit të vet. Nga përgjigjet nuk vërehet ndonjë dallim qenësor ndërmjet burrave dhe grave në një situatë të këtillë.

Konkluzioni dhe rekomandimi: Burrat për shkak të normave shoqërore por edhe për shkak të barrës ndaj obligimeve familjare nuk kanë mundësi të kërkojnë punë jashtë vendit të jetesës dhe aq më pak në shtet tjetër. Edhe pse këto vise tradicionalisht janë të njohura për kurbetin kjo mundësi mbetet e pashfrytëzuar për gratë në nivelin individual për shkak të mospranimit shoqëror që një grua të shkojë në punë jashtë. Gjithashtu shkuarja është vështirësuar edhe për shkak të mospasjes së mjeteve të veta për nisje, mospasjes (ose mosdashjes) së kontakteve dhe lidhjeve fillestare për ndihmë dhe strehim etj.

Përdorimi i teknologjisë informatike për të kërkuar punë bënë të mundshme rritjen për t'iu qasur vendeve të punës edhe për gratë dhe në këtë mënyrë tejkalohen ndërmjetësuesit për të kërkuar punë sikurse janë agjencitë për inkuadrim dhe/ose nevoja e kontaktit të drejtpërdrejtë.

Kombinimi i aspektit profesional dhe ana deficitare e profesioneve me përdorimin e internetit në kontakt direkt me punëdhënësin do të rrisin gjasat për punësimin e vajzave të reja jashtë vendit të jetesës. Me kontakt direkt me punëdhënësin do të tejkalohet nevoja e mbështetjes në vendin e punës sepse shkohet tek punëdhënësi i njohur.

Nxitja e vajzave të reja të vazhdojnë shkollën në drejtime dhe profesione që janë deficitarë në vende të tjera do të ishte një hap drejt inkurajimit të tyre për të kërkuar punë jashtë mjedisit ku jetojnë (qytet tjetër ose shtet tjetër).

Sipas kësaj rekomandohen aktivitete të cilat do të nxisnin arsimimin kualitativ të vajzave të reja fshatare për profesione deficitare (tani për tani ato janë profesionet teknike, ose si profesione tipike meshkujsh) përfshirë këtu edhe njohjen e gjuhës dhe shkathtësinë e komunikimit dhe përdorimin e teknologjisë.

VII. Përshkrimi i punës së preferuar dhe shkathtësitë dhe dituritë e nevojshme

Kur bëhet fjalë se për çfarë tipi të punës konsiderohet si e preferuar së pari theksohen disa karakteristika. Në radhë të parë puna duhet të jetë e përhershme/afatgjate me pagesë të kontributeve për sigurim shëndetësor dhe pensioni dhe me rrogë të mirë dhe të rregullt. Këto dy kushte theksohen si më qenësorët ndërsa largësia, kushtet e punës, ekipi i mirë për punë dhe epror i mirë janë të dyta në rang sipas rëndësisë së faktorëve që bëjnë një punë të mirë pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për mjedisin urban ose rural.

Puna e cila i plotëson karakteristikat e përmendura më lart është puna në sektorin publik dhe për një punë të këtyllë gratë do të pranonin të udhëtojnë në vende të tjera por afër vendit të jetesës.

Angazhimi në punët joformale nuk perceptohen aspak si punësim dhe janë të padëshirueshme për shkak se janë jo të përhershme, të ardhurave të pasigurta dhe mospasje të sigurimit shëndetësor dhe pensionit.

Në lidhje me shkathtësitë e nevojshme për punë theksohen njohja e gjuhëve dhe puna në kompjuterë, shkathtësitë e komunikimit në masën më të madhe si shkathtësi në të cilat gratë janë më të mira. Për dallim nga puna ekipore dhe lideri për të cilat konsiderohet se burrat i kanë dhe dominojnë ato më së miri.

Konkluzione dhe rekomandime: Puna e preferuar për një grua pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për fshat apo qytet është puna në sektorin publik. Dhe kjo në radhë të parë për shkak të sigurisë afatgjate, pagimit të kontributeve, rrogës së rregullt, vendit të punës së definuar si dhe mospasje punë gjatë kohës së vikendit. Kjo punë konsiderohet edhe si shoqërisht e pranueshme dhe për të gratë do të ishin në gjendje të udhëtojnë në qytet tjetër më të afërt.

Nëse përqendrohemi në shkaqet pse puna në sektorin publik është më e preferuar mund të konkludojmë se të gjitha këto kushte janë obligime të cilat punëdhënësit në sektorin e biznesit, sipas ligjit të marrëdhënieve të punës, duhet t'i respektojnë. Për fat të keq kushtet respektohen vetëm në ndërmarrjet publike, institucione dhe ente por jo edhe në sektorin privat. Nëse në shtet krijohen kushte për respektimin e kohës së punës, siguria në rroga si dhe kushtet adekuate dhe qëndrimi ndaj punës do të kontribuojë në përmirësimin e pranimin të mundësive për punë që ofrohet edhe në sektorin privat për gratë. Tani për tani nuk ka raste të këtyllë prandaj sektori publik konsiderohet si punë më e preferuar.

VIII. Masat për mbështetje dhe për përmirësimin e punësimit të grave

Përmirësimi i cilësisë së arsimit do të thotë, kompetencave, dhe jo niveli i arsimit të konsiderohet si faktor kyç për rritjen e punësimit të grave.

Marrja e një pjesë të obligimeve shtëpiake nga ana e institucioneve si për shembull kopshtet publike për kujdes të fëmijëve do të ishin faktor i madh lehtësimi në rritjen e punësimit sepse në disa vende kopshte pothuajse nuk ka fare ndërsa atje ku ka nuk gjenden vende. Si alternativë mbetet angazhimi i personit të tretë që do të kujdesej për fëmijët por ku shërbim është i shtrenjtë dhe i pakapshëm.

Ka nevojë për organizimin dhe mbajtjen e kurseve për kualifikime plotësuese dhe përsosje të kualifikimit por në radhë të parë për gratë që kanë shkathtësi (të fituara në kushte jo formale) dhe ato do të duhej t'i bëjnë formale nëpërmjet certifikatave që të mund të kërkojnë punë ose të hapin biznesin personal

Konkluzione dhe rekomandime: Rritja e punësimit të grave është komplekse dhe nënkupton një varg masash dhe aktivitete të cilat duhet të zbatohen së bashku, sepse në vetvete janë të dobishme por jo sa duhet që të rezultojnë me punësim. Sipas kësaj nëse një grua ndjek kursin e rrobaqepëses kryerja e kursit nuk do të thotë se do të rezultojë me punë dhe në situatë kur ka vend pune në fshatin/qytetin e saj. Punësimi do të varet se a do të ketë përkrahje nga familja në lidhje me kryerjen e obligimeve shtëpiake, dhe se një pjesë të këtyre obligimeve si për shembull kujdesi i fëmijëve do të mund i besohet kopshtit dhe mbase si faktor më qenësor se pronari i fabrikës ose i repartit jep rrogë të rregullt dhe është personalitet me reputacion të pranuar në mjedis.

IX. Në vend të konkluzionit – rrëfimi për Verën dhe sfidat me të cilat ballafaqohet

Gruan e papunësuar nga komuna e Tetovës dhe nga Jegunovce do ta quajmë Vera. Ajo është angazhuar në shtëpi në radhë të parë në plotësimin e obligimeve shtëpiake rreth kujdesit të fëmijëve, pleqve dhe anëtarëve të tjerë të familjes.

Vera ndihmon edhe në punët bujqësore nëse familja posedon tokë ose punon në biznesin familjar, por për këtë punë nuk paguhet, dhe as që për të paguhen kontributet shëndetësore dhe pensionale. Puna e saj nuk duket dhe as që vlerësohet me para kështu që Vera edhe tash edhe në pleqëri do të mbetet ekonomikisht e varur nga burri dhe pastaj edhe nga biri i saj sepse nuk merr rrogë dhe nuk do të marrë as pension.

Edhe pse ka të kryer arsimin e mesëm dhe ndonjëherë edhe të lartë dhe superior, mundësitë e punësimit të Verës janë minimale sepse që të kërkojë punë ajo në radhë të parë duhet të ketë mbështetje (leje) nga burri dhe nga familja më e afërt (vjeherri, vjehrra, baba, nëna). Të sigurosh një përkrahje të këtillë është shumë vështir sepse normat shoqërore imponojnë që burri të jetë ai që do të punojë dhe do të sjellë para në shtëpi. Në rast se Vera do të punonte atëherë burri i saj do të konsiderohej nga mjedisi si i paaftë (“s’është diç me vlerë”) prandaj mbështetja mungon shpesh herë.

Në rastet kur Vera megjithatë do të siguronte mbështetjen atëherë puna formale (punësimi) nuk do të thotë çlirim nga obligimet shtëpiake dhe kujdesi ndaj familjes, por këto edhe më tutje mbeten përgjegjësi e saj. Si rezultat i kësaj Vera e ka të pamundur të përballet me obligimet në shtëpi dhe me ato të punës, veçanërisht në kushte kur nuk ka kushtet me elementare të nevojshme për kujdesin ndaj fëmijëve.

Për këtë grua, edhe sikur të merrte kurajë të kërkonte punë dhe e ka siguruar mbështetjen për të, informacionet që arrijnë tek ajo janë të kufizuara. Pasi ajo është gjithnjë në shtëpi ndërsa informacionet për hapjen e vendeve të punës shpallen në qytet ose nëpërmjet kontakteve me njerëz të tjerë, gjetja e punës është e vështirë dhe proces shumë i mundimshëm.

Barrierë shtesë është se normat dhe rregullat e pashkruara që dominojnë në këtë mjedis ndikojnë në faktin se cila punë është e pranueshme për gra e cila jo. Vera do të dënohej nga mjedisi nëse pranon punë në kafene, çajtoje, bastore, ndërtimtari ose në kazino sepse kjo është e papranueshme.

Gjithashtu për gruan opsioni për të kërkuar punë në qytet tjetër ose në shtet tjetër nuk është opsion pikërisht për shkak të botëkuptimeve tradicionale dhe stereotipave të mjedisit sipas të cilave vetëm burrat mund në mënyrë të pavarur të punojnë jashtë vendit dhe shtetit ku jetojnë.

Për shkak të situatës së pasigurt ekonomike, mosrespektimit të ligjit si dhe komentimeve rigjide të pagesave dhe tatimeve, një numër shumë i vogël i banorëve në përgjithësi marrin guximin të hapin biznes privat dhe të vetëpunësohen. Prandaj edhe Vera vetëpunësimin nuk e sheh si opsion të preferuar për punë. Por edhe sikur të merrte guximin dhe përpiqet të hap biznesin e vet të vogël, për shkak se nuk ka pasuri në emër të vet, nuk ka aftësi për kreditim, nuk ka para për kapital fillestar, Vera pa vullnet të mirë dhe mbështetje të burrit të ose të babës dhe vëllait nëse nuk është e martuar nuk do të ketë sukses.

Puna e vetme që është perceptuar si e preferuar është puna në sektorin publik për shkak të gjithë asaj që nuk e ka ose nuk e respekton sektori privat. Vera do të pranonte të punoj në sektorin publik për shkak të sigurisë në punësim dhe stabilitetit afatgjatë, pagesës së kontributeve dhe kohës së definuar të punës prej 8 orësh si dhe rrogës relativisht të mirë. Për punë të këtyllë ajo do të jetë e gatshme edhe të udhëtojë edhe deri në fshatin apo në qytetin më të afërt nëse mundësia për punësim është atje.

Nëse do të pyetej Vera se si duhet t'i ndihmojnë atëherë ajo do të propozonte dy mënyra. E para dhe më qenësore të bisedohet me mjedisin dhe të ngrihet vetëdija e tij për nevojën e pagesës dhe valorizimit të punës ë Verës të cilën e bënë në shtëpi, në biznesin familjar ose në bujqësi.

Ngritja e vetëdijes së mjedisit për nevojën që edhe Vera të punojë në punë formale jashtë shtëpisë është gjithashtu qenësore, mbase edhe hapi më i rëndësishëm. Në këtë drejtim shteti duhet të ndihmojë duke hapur kopshte për kujdesin e fëmijëve dhe do ta detyrojë sektorin e biznesit që Verës t'ia japin rrogën në kohë për punën e saj sipas dispozitave ligjore.